

III. Shenime per drejtimin e shoqerise

Sipas ligjit Nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë 29.04.2004 parashikohet zbatimi në Shqipëri i dy paketave të rregullimit kontabël (a) Standartet Kombëtare të Kontabilitetit si dhe (b) Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (të njohura si SNRF) për të gjitha shoqëritë tregëtare. Sipas këtij ligji Standardet Kontabël që do të zbatohen nga shoqëritë paraqiten si më poshtë:

- (i) Bankat dhe Institucionet Financiare- të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (ii) Shoqëritë e Mëdha me qarkullim vjetor mbi 1.25 miliard lekë dhe mbi 100 punonjës - të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (iii) Degët e shoqërive të huaja - të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (iv) Shoqëritë e Vogla dhe të Mesme – Standartet Kombëtare Kontabël

Shoqëria Tregtare “VALTELINA” shpk Tirane ka filluar aplikimin e standarteve kombetare te kontabilitetit (SKK) per periudhen ushtrimore qe perfundoi me 31 dhjetor 2008, duke respektuar kerkesat e SKK ne lidhje me bilancin e celjes.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane , në vijim e quajtur shoqëri me përgjegjesi te kufizuar , eshte themeluar me date 16.07.1992 dhe eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit. Kapitali i shoqerise eshte 300,000,000 leke i ndare ne 100 pjese kapitali (kuota) me vlere nominale per nje kuote 3,000,000 Leke/pjesa .

Perfaqesuesi ligjor i shoqerise “VALTELINA” shpk. Tirane, eshte znj. Vjollca HOXHA.

Shoqëria Tregtare eshte e regjistruar ne Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me numer identifikimi NIPT-in J61923012V

Adresa: Rruga Reshit Çollaku, Pallati Tubor, Ap.2/2, Tirane

Objekti i kesaj shoqerie eshte: Perpunim, paketim kafeje, import-eksport, tregtia me shumice dhe pakice e mallrave, sipermarria dhe sherbimi ne fusha te ndryshme; kryerje e transakcioneve ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, kryerja e veprimtarive dhe/ose pjesemarrja ne çdo veprim ose aktivitet ne perputhje me ligjet e Republikës se Shqiperise, apo çdo veprimtari ne lidhje me to, dhe çdo aktivitet ekonomik qe do te konsiderohet i nevojshem dhe i dobishem ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtarise, dhe qe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin Shqiptar.

2. Parimet e pergatitjes se pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabel

Shoqëria Tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane, mban regjistrimet kontabël dhe pergatit pasqyrat financiare në perputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në perputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te publikuara bazuar ne urdherin e Ministrit te Financave, duke perfshire edhe ndryshimet e ndodhura.

(b) Parimet e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike.

Politikat kontabël për shifrat e vitit 2020, janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabel kryesore

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur pasqyrat financiare jane paraqitur sa me poshte:

3.1 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

(b) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj datë.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2020 janë:

Data /Monedha	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Euro	123.70	121.77
USD	100.86	108.62

3.2 Aktivitet e Afatgjata Materiale (AAM)

Në përputhje me SKK AAMateriale dhe “Aktivet Jomateriale”, do të njihen si aktive vetëm ato elementë për të cilat kostoja mund të matet me besueshmëri dhe pritet të hyjnë përfitime ekonomike të ardhshme në shoqëri. Në përputhje me SKK “Rënia në vlerë e Aktiveve”, sa herë që ngjarjet ose ndryshimet në kushtet e tregut tregojnë një rrezik për rënien në vlerë të aktiveve jomateriale të makinerive dhe pajisjeve, duhet bërë një kontroll i detajuar me qëllim që të përcaktohet nëse vlera neto e mbartur e këtyre aktiveve është më e vogël se sa vlera e tyre e recuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e madhe midis vlerës së drejtë (minus kostot e shitjes) dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorim matet duke skontuar flukset e parashikuara të ardhshme të parasë nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivitetit dhe vlerës së tij përfundimtare në nxjerrjen e tij jashtë përdorimit (shitjes). Në rastin kur vlera e recuperueshme është më e vogël se sa vlera neto e mbartur, diferenca midis këtyre dy vlerave do të regjistrohet si humbje nga rënia në vlerë. Humbjet nga rënia në vlerë për makineri dhe pajisje, ose aktivet jomateriale me jetë përdorimi të përcaktuar mund të anulohen nëse vlera e recuperueshme tejkalon vlerën neto të mbartur (por nuk duhet të jetë më e madhe sesa humbja e regjistruar fillimisht).

(i) *Njohja dhe vleresimi*

Shoqëria Tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane, disponon AAMateriale dhe AAJo Materiale. Gjendjet vlerësohen me kosto historike minus zhvlerësimin. Kostoja historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve dhe montimit të tyre deri në venjen në shfrytëzim.

Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative, *kur vlera e riparimit është më e vogël se 15 % e vlerës fillestar e koston se asetit të blere apo të krijuar.*

(ii) *Amortizimi*

Amortizimi per te gjithë zerrat llogaritet dhe njihet me metoden e vlerës lineare, me norma te cilat jane te peraferta me jetegjatesine mesatare te parashikuar te perdorimit si dhe me vleren e mbetur. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen, kurse Nderesat dhe ndertime dhe intalime te pergjithshme me 5 % te vleres se mbetur.

Per AAMateriale e tjera ,normat e amortizimit të përdorura në ndërtimin e PF jane te paraqitura si me poshte:

	<i>Norma Amortizimit %</i>	<i>Metoda Llogaritjes</i>
Makineri pune	20%	Vlera e mbetur
Mjete Transporti	20%	Vlera e mbetur
Paisje Informatike	25%	Vlera e mbetur

3.3 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqeria Tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane, zbaton politkat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 - Inventarët”, kur Shoqeria Tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane, i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e cmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në magazine kur këto kosto mund të indentifikohen me besueshmëri.

3.5 Instrumentat financiare

3.5.1 Aktivet financiare

Shoqeria Tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane, i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: Huadhëniet dhe të Arkëtueshmet të cilat klasifikohen në Llogaritë e arkëtueshme, ndërsa Investimet klasifikohen si të mbajtura deri në maturim. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare.

a. Hua dhe Paradhënie

Huatë dhe Paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativ me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk kuotohen në një treg aktiv, përveç rasteve kur: (a) ato që shoqeria i planifikon ti shesë menjëherë ose në afatshkurtër, të cilat janë të klasifikuara si asete për tregti, dhe ato që shoqeria që në momentin e parë i klasifikon si vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes; (b) ato që shoqeria i kalsifikon si të disponueshme për shitje; ose (c) ato që çdo mbajtës nuk mund të rikuperojë tërësisht gjithë vlerën e investimit fillestare, përveç rastit të përkeqësimit të indeksit të kreditit.

b. Llogari të Arkëtueshme

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë para. Njohja fillestare e kërkesave për t’u arkëtuar ndodh derisa shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen me koston e amortizuar pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t’i mbajtur ato deri në maturim.

Llogaritë e Arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionet për rënie të vlerës.

c. Investimet deri në maturim

Investimet deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturim të fiksuar, për të cilat Drejtimi ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Nëse Shoqëria do të shiste një vlerë të rëndësishme të aktiveve të mbajtura deri në maturim, atëherë e gjithë kategoria do të riklasifikohet si aktive për shitje.

3.5.2 Detyrimet financiare

Shoqëria Tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese. Detyrimet në afatshkurtëra dhe afatgjata si dhe ne logari të pagueshme dhe detyrime financiare.

a. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare. Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit.

b. Huamarrja

Huamarrja njihet fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitjet neto dhe të ardhurat nga shërbimet të realizuara nga aktivitetet kryesore të shoqërisë, duke mos përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH). Të ardhurat kryesore të shoqërisë gjenerohen nga Perpunim dhe paketim kafeje, import-eksport, tregtia me shumice dhe pakice e mallrave, sipermarrja dhe shërbimi në fusha të ndryshme;

3.6.1 Shitja e mallrave dhe shërbimeve.

Të ardhurat nga perpunim, paketim kafeje, import-eksport, tregtia me shumice dhe pakice e mallrave, sipermarrja dhe shërbimi në fusha të ndryshme njihen kur malli dhe shërbim është kaluar te klienti, në baze të faturave të shitjes. Përgjithësisht, të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose që do të arkëtohet. Në rastin kur një pagesë e shtyrë ka një ndikim të rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së drejtë, do të llogaritet duke skontuar pagesat e ardhshme. Vlerësimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse do të njihen ose jo të ardhurat ose shpenzimet.

Si pjesë e procesit të njohjes së të ardhurave “VALTELINA” shpk Tirane, vlerëson nëse do të rrjedhin përfitime ekonomike të lidhura me transaksionin.

Nëse shoqëria “VALTELINA” shpk. Tirane, ka pasiguri nëse do të hyjnë apo jo përfitime ekonomike, njohja e të ardhurave shtyhet dhe njihen mbi baza monetare. Megjithatë, nëse ka pasiguri rreth mbledhjes së një shume tashmë të përfshirë në të ardhurat, shumën në lidhje me të cilën është e pamundur që të arkëtohet ajo njihet si shpenzim në zërin e koston të mallrave të shitura.

3.6.2 Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi njihen në proporcion me kohën duke u bazuar në metodën e interesit efektiv. Kur një llogari e arkëtushme është vështirë për t'u arkëtuar, shoqëria "VALTELINA" shpk. Tirane zvogëlon vlerën e mbartur deri në vlerën e rekuperueshme, duke konsideruar që flukset e ardhshëm të parashikuara të skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të instrumentit, dhe vazhdon të pakësojë zbritjen duke njohur të ardhurat nga interesi.

3.6.3 Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Ne kete grup te ardhurash perfshihen te ardhurat qe perfitoohen jo rregullisht gjate rrjedhes normale te veprimtarise. Ku perfshihen fitimet nga gjobet , investimi , ndryshimi i kursit e te ardhura te tjera.

3.7 Provizionet

Provizioni njihet kur shoqëria "VALTELINA" shpk. Tirane, ka nje detyrim aktual qe ka lindur nga nje ngjarje e shkuar, shlyerja e te cilit pritet te shoqerohet me dalje te burimeve dhe mund te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

3.8 Tatimi aktual mbi fitimin

Shoqëria Tregtare "VALTELINA" shpk. Tirane, zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin e shtyrë. Për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohjura sipas përcaktimit të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat". Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

3.9 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM në dore dhe ato të mbajtura në banka. Në përputhje me SKK 7 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshijnë MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak). Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshijnë investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktivitetëve (kontrollat e këmbimit, etj).

4. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit

Shoqëria Tregtare "VALTELINA" shpk. Tirane, kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Çmuarjet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet që janë të arësishme sipas rrethanave.

(i) Tatimi mbi të ardhurat

Shoqëria Tregtare "VALTELINA" shpk. Tirane është subjekt i tatimit mbi të ardhurat. Në përcaktimin e provizioneve të tatimit mbi të ardhurat janë të nevojshme çmuarjet. Ekzistojnë shumë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë gjatë veprimtarisë normale të biznesit. Shoqëria Tregtare "VALTELINA" shpk. Tirane njih detyrimet për vlerësimet e organeve tatimore bazuar në vlerësimet nëse tatime të tjera shtesë do të lindin si detyrime.

(ii) **Testi i rënies së vlerës**

a. Llogaritë e arkëtueshme

Shoqëria Tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane, teston llogaritë e saj të arkëtueshme nëse ato kanë rënie në vlerë në përputhje me politikat kontabël .

b. **Krahasueshmëria**

Informacioni krahasues është paraqitur në përputhje me politikat kontabël që zbatohen nga Shoqëria Tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane. Janë bërë korigjimet e nevojshme për shifrat krahasuese në përputhje me ndryshimet në paraqitjet në periudhën aktuale.

5. Të ardhurat

“VALTELINA” shpk. Tirane, i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e Performances sipas natyrës.

	31 dhjet 2020	31 dhjet 2019
Te Ardhurat nga aktiviteti kryesor	374,747,254	399,364,272
Te ardhura te tjera te shfrytëzimit pakesim i prodhimit te gatshem.	-13,406,941	19,900,332
Ta ardhura nga interesa e tjera financiare	0	0
Total	361,340,313	419,264,604

6. Shpenzimet per materiale te konsumuara

Në këtë post është përfshirë kostoja e mallrave të shitura , qe perbehet nga kostoja e blerjes së mallrave per rishitje plus ose minus ndryshimin e gjendjes .

	31 dhjet 2020	31 dhjet 2019
Shpenzime per materiale konsumuara	147,482,385	171,894,960
Te tjera shpenzime materiale e sherbime	0	0
Total	147,482,385	171,894,960

7. Shpenzime personeli

Ne shpenzimet per personelin, jane përfshirë shpenzimet per paga, shperblime dhe sigurime shoqerore e shëndetsore të llogaritura gjatë vitit 2020. Gjate vitit shoqëria tregtare “VALTELINA” shpk. Tirane ka llogaritur, deklaruar dhe paguar ne përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punonjësit. Përbërja e nënzërit të shpenzimeve të pagave paraqitet si vijon:

Shpenzime per paga dhe sigurime shoqerore	31 dhjet 2020	31 dhjet 2019
Shpenzime Pagat	42,705,389	42,172,269
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore	6,749,737	6,994,034
Total	49,455,126	49,166,303

Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetsore paraqiten shuma e kontributeve që llogaritet dhe paguan shoqëria “VALTELINA” shpk. Tirane. Tirane mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me normat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetsore.